



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_/\_\_/2018

**V E N D I M**

**Nr. 118, Datë 07.05.2018**

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.48 Regj., datë 18.04.2018, të z.V. F, kundër Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë<sup>1</sup>, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe të “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Subjekti ankues, z.V. F përmes ankesës së tij shprehet se që nga viti 2011 është trajtuar me pagesë paaftësie pasi është diagnostifikuar me diagnozën: amputatio brachi sin<sup>2</sup>. Këtë trajtim e ka përfituar deri në vitin 2015, pasi ankuesi shprehet se: *“Ma kanë ndërprerë pagesën e paaftësisë me argumentin se nuk kam vjetërsi pune, kur unë e kam të pamundur të punoj për arsye shëndetësore. Jam i papunë dhe jetoja vetëm me të ardhurat e kempit. Unë penalizohem nga ndryshimi që i është bërë Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore”, pasi më përpara e përfitoja”*. Referuar dokumentacionit<sup>3</sup> sjellë pranë Komisionerit subjekti ankues është kryefamiljar dhe familja e tij ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri që t’i rikthehet e drejta e përfitimit të pagesës së paaftësisë.

**Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KMCAE Epror.

<sup>2</sup> Ankuesi përfitonte paaftësi Grupi Dytë.

<sup>3</sup> Certifikatë familjare e Zyrës së Gjendjes Civile Bradashesh, datë 18.04.2017.

Së pari, lidhur me pretendimet e z.V. F, për kundërshtimin e vendimit të Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, Komisioneri informon subjektin ankues, se vendimi i këtij Komisioni është i formës së prerë. Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtij organi nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup>.

Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 39/1 “Ankimimi në Komisionin Epror”, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: **“Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”**.

Ligji për Sigurimet Shoqërore deri në vitin 2011 në nenin 35 të tij, e cilësonte vendimin e KMCAP Epror si vendim të paapelueshëm. Paapelueshmëria në këtë rast lidhet vetëm me paapelueshmërinë për ekspertizën, pra, për vendimin mjekësor, për shkak të natyrës së veçantë juridike. Një vendim i tillë, nuk mund të ‘goditet’ në gjykatë lidhur me vendimin e ekspertizës mjekësore.

Në çështjen Dauti kundër Shqipërisë<sup>5</sup>, GJEDNJ<sup>6</sup> thekson se: *“E drejta për në gjykatë, mbulon çështjet e faktit po aq sa edhe çështjet e ligjit”*. Po kështu sipas kësaj gjykate: *“...përfitimet e mirëqenies dhe të drejtat e sigurimeve shoqërore janë “të drejta civile” brenda kuptimit të nenit 6/1 të Konventës për të Drejtat e Njeriut<sup>7</sup>, i cili zbatohet në gjykimin në lidhje me to. Kjo çështje ka të bëjë me të drejtën e ankimesit për përfitime mirëqenieje, që është pagesa e paaftësisë që rrjedh nga paaftësia e tij për punë”*.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cenimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Sipas këtij standardi, individit, në rastin e një vendimi administrativ përfundimtar, ky vendim duhet t’i jepet nga organe administrative që garantojnë cilësitë e një “organi të pavarur dhe të paanshëm”. Prandaj dhe kur ligji përcakton vendimet administrative si vendime të formës së prerë, duhet të garantojë dhe pavarësinë e një organi administrativ njësoj si të ishte “gjykatë” për shqyrtimin e çështjes. Në të kundërt, gjykatat e zakonshme duhet t’i japin akses individit si për çështje ligji dhe për çështje fakti, në mënyrë që atij t’i garantohet e drejta në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në lidhje me pozicionin e KMCAP epror, si organ *quasi* gjykatë, vendimet e të cilit janë të formës së prerë, ligjvënësi pas vendimit Dauti ka bërë rregullime duke ndryshuar rregullat me qëllim përputhjen me kriteret e GJEDNJ për një “organ të pavarur dhe të paanshëm.

<sup>4</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KMD.

<sup>5</sup> Vendim i datës 3 Shkurt 2009.

<sup>6</sup> Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>7</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KEDNJ

(Megjithë ndryshimet e pësuar në këtë Ligj, sërisht nuk u ndryshua paapelueshmëria e vendimeve të tyre, sa i takon vendimit mjekësor apo ekspertizës mjekësore).”<sup>8</sup>.

*Së dyti*, lidhur me pretendimin e z.V. F se është penalizuar nga ndryshimet e fundit të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri informon ankuesin se e njëjta çështje është në shqyrtim pranë KMD-së. Lidhur me këtë problematikë, Komisioneri ka iniciuar kryesisht, në zbatim të Urdhërit nr.28, datë 13.02.2018, “Fillimin e procedurave për ndjekjen “ex-officio” të çështjes në lidhje me rregullimin e së drejtës për t’u rivlerësuar në KMCAP të të gjithë personave me aftësi të kufizuara të cilët janë invalid pune”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Bazuar në nenin 33, pika 4/c/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 7, pika 1, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe nënenin 33, pika 4, gërma c) dhe ç), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së z.V. F, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

---

<sup>8</sup>Dr.E.T.Dobjani: “Mbi kontrollin kushtetues të akteve të autoriteteve jo gjyqësore mbi respektimin e procesit të rregullt ligjor”.

2. Komisioneri i rekomandon subjektin ankues t'i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike<sup>9</sup>, ose Shërbimit Ligjor Falas<sup>10</sup>.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në gjykatë, brenda afatit 45 ditor nga marrja e dëgjimit, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Fusha: Shërbime

Shkaku: Aftësi e kufizuar, Racë

---

<sup>9</sup>Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. 'Zogu i Parë', Tiranë.

<sup>10</sup>Me adresë: Rruga "Sami Frashëri", 4 kullat, seksioni III, Ap. 1A, Kutia Postare nr.69, Tiranë  
Nr.tel.: 0422 53114